



# RANGIMI I INSTITUCIONEVE

SIPAS PERFORMANSAVE  
PËR PARANDALIM TË  
KORRUPSIONIT NË  
PROKURIMET PUBLIKE



**RANGIMI I**  
**INSTITUCIONEVE**  
SIPAS PERFORMANSAVE  
PËR PARANDALIM  
TË KORRUPSIONIT NË  
PROKURIMET PUBLIKE

Shkup, Mars 2024



## RANGIMI I INSTITUCIONEVE SIPAS PERFORMANSAVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE

(превод на публикацијата РАНГИРАЊЕ НА ИНСТИТУЦИИТЕ СПОРЕД АНТИКОРУПЦИСКИТЕ ПЕРФОРМАНСИ ВО ЈАВНИТЕ НАБАВКИ)

### Botuesi:

Qendra për Komunikime Qytetare

### Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

### Dizajn grafik:

Brigada Dizajn

### Printoi:

Brigada Dizajn

### Tirazhi:

50

Tirazhi falas/jokomercial

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352:35.073.53]:354(497.7)(047.31)

343.352:35.073.53]:352(497.7)(047.31)

RANGIMI i institucioneve : sipas performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike / përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Agon Ismaili. - Shkup : Qendra për Komunikime Qytetare,

2024 (Shkup : Brigada Dizajn). - 52 стр. : илустр. ; 20 см

Превод на оригиналот: Рангирање на институциите според антикорупциските перформанси во јавните набавки

ISBN 978-608-4974-34-5

а) Антикорупција -- Јавни набавки -- Министерство -- Рангирање -- Македонија -- Истражувања б) Антикорупција -- Јавни набавки -- Локална самоуправа -- Рангирање -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 63763973

Ky publikim është përgatitur nga Qendra për Komunikime Qytetare me përkrahjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



## PËRMBAJTJA

HYRJE DHE SHËNIME METODOLOGJIKE.....	4
ANALIZË E PERFORMANSAVE TË MINISTRIVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE.....	6
ANALIZË E PERFORMANSAVE TË KOMUNAVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE.....	22
LISTA E TREGUESVE PËR VLERËSIMIN E PERFORMANSAVE TË INSTITUCIONEVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE.....	47



## HYRJE DHE SHËNIME METODOLOGJIKE

**V**lera e prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbën 24% të buxhetit të shtetit, ndërsa 8% të prodhimit bruto të brendshëm. Prokurimet publike, vlera vjetore e të cilave e tejkalon shumën prej 1 miliard euro, janë veçanërisht të ndjeshme ndaj korrupsionit. Për të zvogëluar mundësitë për korrupsion në këtë sferë, është e nevojshme të bëhen përpjekje shtesë si në nivel sistemik ashtu edhe në nivel institucional.

Në nivel sistemik, është e nevojshme të përforcohen përpjekjet për parandalim të korrupsionit tek të gjitha institucionet dhe autoritetet kompetente me qëllim të zbulimit dhe sanksionimit të korrupsionit, duke filluar nga Byroja për Prokurime Publike dhe Komisioni Shtetëror për Ankesa lidhur me Prokurimet Publike, nëpërmjet Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Entit Shtetëror për Revizion e deri te Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit dhe jurisprudencës.

Megjithatë, në nivel institucional është e nevojshme të vlerësohet në mënyrë të matshme dhe të qëndrueshme aftësia e vetë institucioneve për të parandaluar korrupsionin gjatë zbatimit të prokurimeve publike. Institucionet kanë përgjegjësinë kryesore për zbatimin ligjor në tenderët dhe për shpenzimin efektiv dhe efikas të parave publike nëpërmjet procedurave të prokurimeve publike.

Për t'u bërë kjo e mundur, është zhvilluar ky instrument për të matur performansat e institucioneve për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike, i cili bazohet në 32 tregues që mundësojnë një vlerësim objektiv të kapaciteteve institucionale dhe operacionale të institucioneve në të gjitha fazat e prokurimeve publike, domethënë në fazën para tenderit, në fazën gjatë tenderit dhe pas tenderit.

Faza para tenderit përfshin tregues që janë në lidhje me kapacitetin e të punësuarve të institucionit për të zbatuar prokurimet publike, me zbatimin e politikave dhe procedurave adekuate të brendshme, si dhe me treguesit në lidhje me matjen e performansave për parandalim të korrupsionit në planifikimin e prokurimeve publike.

Faza e tenderit përfshin tregues që janë në lidhje me mënyrën në të cilën zbatohen procedurat e prokurimeve publike, duke filluar nga dokumentet që përdoren në tender, përmes konkurrencës që mundësohet, koncentracionin e ofertuesve, kontratat e lidhura me një ofertues, kontratat e lidhura në procedura jotransparente, ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit, etj.

Faza pas tenderit përfshin tregues të cilët janë në lidhje me sistemin e vendosur për monitorimin e realizimit të kontratave të lidhura për prokurime publike, zbatimin konsekuent të këtyre kontratave dhe transparencën e mundësuar. Një prezantim i detajuar i 32 treguesve për matjen e performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike është paraqitur në fund të kësaj analize.

Përzgjedhja e treguesve përfundimtarë sipas të cilëve bëhet vlerësimi dhe rangimi i institucioneve sipas performansave për parandalim të korrupsionit gjatë zbatimit të prokurimeve publike, është bërë sipas:

- vlerësimi të rëndësisë, aktualitetit dhe saktësisë së treguesve të deritanishëm që i përdor QKQ;
- njohurive për nevojat dhe matjet e reja të korrupsionit në prokurimet publike, si dhe
- hulumtimit të matjeve të tilla të ngjashme në vende të tjera të botës.

Për secilin tregues janë përcaktuar: emri i treguesit, përgjigjet e pritshme potenciale, burimi i informacionit për vlerën e treguesit, përcaktimi i koeficientëve dhe pesha e vlerësimi me pikë dhe pikët e mundshme.



Për secilin nga 32 treguesit mund të fitohen më së shumti 2 pikë, që donë të thotë se numri total i pikëve që mund të fitojë një institucion është 64, përkatësisht kjo është 100%.

Pas vlerësimit me pikë, institucionet rangohen sipas përqindjeve të fituara, në tri kategori – sipas parimit të semaforit, gjegjësisht e kuqe, e verdhë dhe jeshile, për kuptim më të lehtë dhe më të thjeshtë nga publiku dhe për qytetarët.

**Rangimi i institucioneve sipas performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike bëhet në këtë mënyrë:**

0% deri 50%	NIVELI I ULËT
50% deri 80%	NIVELI MESATAR
80% deri 100%	NIVELI I LARTË

Për sa i përket rangimit, nivel i ulët nuk nënkupton domosdoshmërisht korrupsion në prokurimet publike **të atij institucioni, por** donë të thotë se nuk ndërmerren masa të mjaftueshme për mbrojtje nga korrupsioni, gjë që sugjeron në mungesë efikasiteti dhe në potencial për korrupsion.

Treguesit janë përlogaritur për 100 institucione të pushtetit qendror dhe lokal, përkatësisht Qeveria, ministritë, sekretariatet qeveritare, si dhe për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale. Përlogaritja e treguesve është bërë në bazë të përpunimit dhe analizës së të dhënave përkatëse për të gjitha 5138 procedurat e prokurimeve publike të zbatuara nga institucionet e përfshira në vitin 2022 në vlerë prej 17,4 miliardë denarë (283 milionë euro), kurse një pjesë e të dhënave është marrë nga vetë institucionet nëpërmjet kërkesave për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik.

Analiza e bërë korrespondon edhe me kërkesat e Bashkimit Evropian nga vendi ynë, duke qenë se në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për vendin është vlerësuar që “autoritetet nacionale duhet të inkorporojnë masa më efektive për parandalim të korrupsionit në ciklin e prokurimeve.”




## ANALIZA E PERFORMANSAVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE TË MINISTRIVE

**A**snjë ministri nuk i zbaton prokurimet publike me nivel të lartë të mbrojtjes nga korrupsioni. Qeveria, sekretariatet<sup>1</sup> dhe ministritë e saj mezi arrijnë nivelin mesatar të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike dhe mesatarisht plotësojnë vetëm 57% nga 100% të mundshme. Ministria për Arsim dhe Shkencë, Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive kanë ekspozimin më të madh ndaj korrupsionit.

Rangimi që është bërë në bazë të 32 treguesve të performansave për parandalim korrupsionit në prokurimet publike mundëson që institucionet të kategorizohen në një nga tre nivelet – niveli i lartë, mesatar ose niveli i ulët i mbrojtjes. Nga analiza e thellë ka rezultuar që katër ministri janë në zonën e kuqe, përkatësisht me nivel të ulët të performansave për parandalim të korrupsionit me pikë prej më pak se 50% për mënyrën se si i zbatojnë prokurimet publike. Ndërsa pjesa tjetër e institucioneve qeveritare janë në zonën e verdhë me nivel mesatar të performansave prej 50% - 80%.

Rangimi i Qeverisë dhe ministrive sipas performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike



Niveli më i ulët të realizimit të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike është konstatuar te Ministria për Arsim dhe Shkencë dhe Ministria për Punë të Brendshme me vetëm 39% nga 100% të mundshme. Pastaj vijon Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor me 44% dhe Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive me 48%.

Niveli i ulët, nuk nënkupton medoemos që ka korrupsion në prokurimet publike në institucionin konkret, por se nuk ndërmerren të gjitha masat e mundshme, të cilat duhet të parandalojnë korrupsionin dhe së këtejmi, mundësia që në këto institucione të ndodh korrupsion është më e madhe.

Performansat më të larta për parandalim të korrupsionit janë konstatuar në Ministrinë për Mbrojtje dhe Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra, me një nivel prej 72%. Mirëpo edhe këto institucione janë me nivel mesatar të performansave për parandalim të korrupsionit.


<sup>1</sup> Në vitin 2022, Sekretariati për Legjislacion i Qeverisë së RMV-së ka zbatuar vetëm dy procedura për prokurime publike me vlerë të përgjithshme prej 477,963 denarë. Duke e pasur parasysh numrin e vogël të tenderëve, vlerësimi ishte që rangimi i tyre nuk do të ishte i përshtatshëm.





Asnjë ministri nuk ka performansa për parandalim të korrupsionit mbi 80% për të qenë në nivelin e lartë në zonën e gjelbër.

**Realizimi i performandave për parandalim të korrupsionit  
në prokurimet publike të Qeverisë dhe ministrive**



Ministritë që janë në radhët e fundit të rangimit sipas nivelit të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike nuk i kanë zbatuar të gjitha procedurat e duhur të brendshme, kanë dobësi në planifikimin e prokurimeve, konkurrencë të pamjaftueshme në tenderët, kanë përqindje të lartë të procedurave në të cilat merr pjesë vetëm një kompani, shpesh i anulojnë tenderët, nuk i publikojnë me kohë njoftimet për kontratat e lidhura, përqindja e ankesave është mbi mesataren në raport me numrin e përgjithshëm të shpalljeve, etj.


**Më shumë se gjysma e vlerës së prokurimeve publike të Qeverisë dhe ministrive shpenzohet nga ato që janë me nivel të ulët të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike. Katër ministritë që janë me nivelin më të ulët në rangim kanë lidhur kontrata për prokurime publike në vlerë prej 93 milionë euro brenda një viti, për dallim nga ministritë dhe sekretariatet që janë me performansa të nivelit mesatar për parandalim të korrupsionit dhe kanë shpenzuar 71 milion euro.**



Gjatë vitit 2022, Qeveria, ministritë dhe sekretariatet kanë zbatuar gjithsej 1263 procedura për prokurime publike përmes të cilave kanë lidhur 1381 kontratë për prokurime publike. Vlera e prokurimeve është 10 miliardë denarë, gjegjësisht 164 milionë euro. Megjithëse, 4 nga 19 institucione qeveritare ishin në zonën e kuqe me nivel të ulët të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike, prapë se prapë këto katër ministri shpenzojnë më tepër se gjysmën e parave (57%).

Më konkretisht, në vitin 2022, Ministria për Arsim dhe Shkencë, Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, si dhe Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive kanë lidhur 363 kontrata në vlerë prej 5,7 miliardë denarësh, apo 93 milionë euro. Institucionet tjera qeveritare kanë lidhur 1018 kontrata për prokurime publike në vlerë prej 4,4 miliardë denarë, gjegjësisht 71 milion euro.

**Vlera e prokurimeve publike sipas nivelit të performansave për parandalim të korrupsionit në vitin 2022 (në milionë euro)**



Siç shihet nga tabela më poshtë, Ministria për Punë të Brendshme është në krye sipas vlerës së kontratave, me 216 kontrata të lidhura në vlerë prej 4,4 miliardë denarë, përkatësisht 68 milionë euro. Në vendin e dytë është Ministria për Mbrojtje, e cila edhe pse nuk është në zonën e kuqe dhe është ndër ato me performansat më të larta, ka ende shumë vend për përmirësim.



Numri dhe vlera e kontratave të lidhura të ministrive në vitin 2022\*

Institucioni	Numri i kontratave të lidhura	Vlera e kontratave në denarë	Vlera e kontratave në euro
Ministria për Punë të Brendshme	216	4,192,782,093	68,175,319
Ministria për Mbrojtje	356	1,242,850,087	20,208,945
Ministria e Shëndetësisë	65	1,227,332,058	19,956,619
Ministria për Arsimit dhe Shkencë	71	1,006,663,888	16,368,519
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	54	488,037,869	7,935,575
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	36	484,853,451	7,883,796
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë me Ujëra	78	303,081,707	4,928,158
Ministria për Transport dhe Lidhje	74	268,565,606	4,366,920
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	30	244,628,910	3,977,706
Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta	91	196,093,086	3,188,505
Ministria për Financa	84	162,127,408	2,636,218
Ministria për Punë të Jashtme	61	86,846,407	1,412,137
Ministria për Drejtësi	35	42,259,162	687,141
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	40	42,132,739	685,085
Ministria për Ekonomi	26	38,337,166	623,369
Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive	22	33,304,247	541,532
Sekretariati për Çështje Evropiane	16	26,592,002	432,390
Ministria për Kulturë	16	18,377,666	298,824
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	10	2,458,304	39,972

\* adhitja është bërë sipas madhësisë së vlerës së prokurimeve publike

Rëndësia e paraqitjes së vlerës së prokurimit publik në nivel të institucioneve buron nga fakti që përgjegjësia për përmirësimin e performansave për parandalim të korrupsionit në zbatimin e prokurimeve publike duhet të jetë më e madhe ashtu si rritet vlera e kontratave të prokurimeve publike. Me të drejtë duhet të pritët që institucionet më të mëdha t'i përdorin burimet e tyre në funksion të përmirësimit të kapaciteteve të personelit dhe institucionale për zbatimin e prokurimeve publike.

**Në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë, një person i angazhuar për prokurime publike zbaton vetëm 3 procedura në nivel vjetor, ndërsa në Ministrinë për Punë të Brendshme trembëdhjetë herë më shumë, pra 39 procedura. Përveç se në Ministrinë për Punë të Brendshme, personel i pamjaftueshëm në fushën e prokurimeve publike është vërejtur edhe në Ministrinë për Transport dhe Lidhje, Ministrinë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor dhe në Ministrinë për Drejtësi.**

Në fillim të listës me 32 tregues për vlerësimin e realizimit të performansave për parandalim të korrupsionit janë ato që kanë të bëjnë me vlerësimin e kapaciteteve të personelit të institucioneve për zbatimin e prokurimeve publike. Vlerësimi është bërë përmes numrit të personave, të cilët në institucion kryejnë punë në fushën e prokurimeve publike, sa prej tyre kanë certifikatë të vlefshme për dhënien e provimit për prokurime publike dhe përlllogaritje të numrit të tenderëve të cilët i realizon një person.


Ministria për Mbrojtje ka numrin më të madh të punonjësve, me 22 persona, nga të cilët provimin e kanë dhënë të gjithë, pastaj është Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë me 8 persona, më pas Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta (SHPPP) me 7 persona, ndërsa pas tyre vijojnë Ministria për Financa dhe Ministria për Arsimit dhe Shkencë



me nga 6 persona. Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Punë të Jashtme dhe Ministria për Shëndetësi kanë të njëjtin numër punonjësish që kryejnë punë në fushën e prokurimeve publike, nga 5 secili nga resorët e fundit. Gjatë kësaj, me rëndësi është që të kihet parasysh se vlera e prokurimeve publike në Ministrinë për Punë të Brendshme është 4,2 miliardë denarë (68 milionë euro), ndërsa në Ministrinë për Punë të Jashtme madje 48 herë më pak, përkatësisht rreth 87 milionë denarë (1,4 milion euro). Kjo situatë gjithsesi sugjeron në mungesë të çfarëdo standardi për numrin e të punësuarve në institucionet qeveritare varësisht prej vëllimit të prokurimeve publike.

Sa i përket treguesit për numrin e procedurave të prokurimeve publike të zbatuara nga një person, institucionet vlerësohen pozitivisht nëse një person zbaton më pak se 24 procedura në vit. Siç shihet nga prezantimi më poshtë, rezultojnë se në Sekretariatën e Përgjithshme të Qeverisë, ku një person i angazhuar për prokurime publike zbaton vetëm 3 procedura, ndërkaq në Ministrinë për Punë të Brendshme deri në 39 procedura në vit. Përveç në Ministrinë për Punë të Brendshme, numër të pamjaftueshëm të personelit në fushën e prokurimeve publike është vërejtur edhe në Ministrinë për Transport dhe Lidhje, Ministrinë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor dhe në Ministrinë për Drejtësi.

### Numri i procedurave të zbatuara nga një person



\* Të dhënat e prezantuara janë nga viti 2023

Tek të gjitha institucionet është konstatuar që anëtarët e komisioneve për prokurime publike ndërrohen, gjë që vlerësohet pozitivisht.



**Vetëm në Ministrinë për Vetëqeverisje Lokale ka përqindje të vogël të ndryshimeve të planit dhe përqindje të lartë të realizimit të tij. Mirëpo, kjo situatë e cila i është mundësuar për shkak të vëllimit të vogël të prokurimeve, nuk është konstatuar te ministrinë tjera. Ndryshimet më të mëdha të planeve janë bërë nga Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, ndërsa përqindja më të ulët e realizimit është në Ministrinë e Financave me 29%.**

Në segmentin e planifikimit të prokurimeve publike, vlerësimi është pozitiv nëse plani për prokurime publike ka qenë lëndë e ndryshimit më pak se 10%, kurse përqindja e realizimit ka qenë mbi 95%. Niveli mesatar i përmbushjes së këtyre treguesve është nëse plani është ndryshuar nga 10 – 30%, ndërsa plani i prokurimeve publike është me shkallë realizimi prej 75 – 95%.

#### Ndryshimi dhe realizimi i planeve për prokurime publike\*

Institucioni	Ndryshimi i Planit për PP	Realizimi i Planit për P
Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	39%	88%
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	22%	64%
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	21%	44%
Ministria për Financave	21%	71%
Ministria për Kulturë	18%	76%
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	18%	55%
Ministria për Punë të Brendshme	17%	51%
Ministria për Arsim dhe Shkencë	17%	39%
Ministria për Shëndetësi	16%	39%
Ministria për Mbrojtje	15%	69%
Ministria për Transport dhe Lidhje	13%	60%
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujërat	11%	53%
Ministria për Drejtësi	11%	55%
Ministria për Punë të Jashtme	9%	70%
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	8%	100%
Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta	6%	69%
Ministria për Ekonomi	6%	60%
Sekretariati për Çështje Evropiane	5%	72%
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë	2%	47%

\* Të dhënat janë për vitin 2022

Sa i përket vendosjes së një sistemi për monitorimin e realizimit të planeve të prokurimeve publike, tre ministri janë përgjigjur që nuk kanë një sistem të tillë, përkatësisht Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Ministria për Vetëqeverisje Lokale dhe Ministria për Arsim dhe Shkencë.

Vetëm 7 nga 19 institucionet qeveritare në mënyrë konsekuente e respektojnë Ligjin për Prokurimet Publike dhe përpilojnë arsyetim të nevojës për prokurimin. Gjendja është diçka më e mirë për sa u përket rregullave të brendshme për përlllogaritjen e vlerës së përlllogaritur të cilat i kanë 11 prej 19 institucioneve. Ndërsa, po aq institucione kanë rregulla të brendshme në lidhje me përgatitjen e specifikimeve teknike.



**Pjesa më e madhe e ministrive u përmbahen afateve të përcaktuara me ligj për dërgimin e ofertave, afate të cilët janë relativisht të shkurtër dhe sfidues për kompanitë më të vogla. Për sa i përket ankandit elektronik, aplikimi i lartë i kësaj forme (në mbi 80% të tenderëve) është vërejtur në 6 ministri.**

Në procesin e zbatimit të tenderëve, janë analizuar edhe performansat e institucioneve lidhur me afatet e parapara për grumbullimin e ofertave (ato duhet të jenë më të gjatë nga afati minimal ligjor), si dhe niveli i aplikimit të ankandit elektronik (e-ankand). Nevoja për afate më të gjata për dërgimin e ofertave buron nga synimi për të nxitur konkurrencë më të madhe dhe që kompanive t'u mundësohet një periudhë më e gjatë për përgatitjen e ofertave. Lidhur me ankandin elektronik, aplikimi i lartë i tij vlerësohet negativisht sepse mundëson marrëveshje korruptive ndërmjet kompanive dhe kjo shkakton probleme serioze në sferën e prokurimeve publike duke e ndarë tregun dhe duke i ngritur çmimet në nivel jorealisht të lartë.

Nga analiza e performansave të institucioneve rezulton se madje 11 nga 19 institucionet e analizuar përcaktojnë afate të cilat janë në nivel të minimumit ligjor, e që në raport me procedurat më së shpeshti të aplikuara, nënkuptojnë 7 ditë për "prokurimet me vlerë të ulët" dhe 15 ditë për "procedurë të hapur të thjeshtësuar". Në listën e institucioneve që u përmbahen afateve minimale ligjore janë Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, Sekretariati për Çështje Evropiane dhe Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Ekonomi, Ministria për Shëndetësi, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Ministria për Kulturë, Ministria për Vetëqeverisje Lokale, Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Ministria për Drejtësi dhe Ministria për Politikë dhe Punë Sociale.

Sa i përket ankandit elektronik, aplikimi i lartë i tij në mbi 80% të tenderëve është vërejtur në 6 ministri, përkatësisht në Ministrinë për Punë të Brendshme, Ministrinë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Ministrinë për Kulturë, Ministrinë për Arsim dhe Shkencë, Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministrinë për Transport dhe Lidhje si dhe nga SHPPP.

**Numri mesatar i ofertave për tender të Qeverisë dhe ministrive është më i ulët nga mesatarja nacionale. Ministria për Financa ka pasur numrin më të ulët të ofertave, vetëm 1.89 ofertues për tender, ndërsa Ministria për Kulturë ka pasur numrin më të lartë prej 4.13 oferta për tender.**


Në procesin e zbatimit të procedurave janë marrë parasysh një varg treguesish, të cilët në pjesën kryesisht pasqyrojnë se si ka qenë konkurrenca në procedurat e prokurimeve publike. I pari në vargun e treguesve është numri mesatar i ofertuesve.

Përlllogaritja e numrit të ofertuesve për të gjitha kontratat për prokurimet publike të lidhura nga institucionet gjatë vitit 2022 tregon që numri mesatar i ofertave për tender të institucioneve qeveritare është 2.91 ofertues për tender dhe është më i ulët nga mesatarja nacionale e cila arrin deri 3.01.

Siç mund të shihet nga prezantimi grafik në vijim, Ministria për Financa ka pasur numrin më të ulët të ofertave, me vetëm 1.89 ofertues për tender, kurse numri më i lartë ka qenë në Ministrinë e Kulturës me 4.13 oferta për tender. Nga aspekti i performansave për parandalim të korrupsionit, institucionet me numër mesatar të ofertuesve më të lartë se 3.01 oferta vlerësohen pozitivisht dhe e kundërta.



### Numri mesatar i ofertuesve për tender



**Ministria për Financa, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministria për Punë të Brendshme, si dhe Shërbimi për Çështje të Përgjithshme dhe të Përbashkëta kanë performansat më të dobëta bëhet fjala për tenderët në të cilët është dërguar nga një ofertë edhe nga aspekti i numrit të tenderëve të tillë edhe nga aspekti i pjesës së vlerës së tyre.**

Duke e pasur parasysh se një nga parimet bazë mbi të cilët bazohen prokurimet publike është konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë (kompanive), rangimi përfshin edhe tregues të tjerë që kanë të bëjnë me këtë parim të rëndësishëm.

Bëhet fjalë për përlogaritjen e numrit të tenderëve në të cilët institucioni ka pranuar vetëm një ofertë, si dhe për pjesëmarrjen e vlerës së atyre tenderëve në vlerën totale të kontratave të lidhura për prokurime publike është zbatuar qasja në vijim. Vlerësohet pozitivisht nëse institucioni ka përqindje tenderësh me një ofertë deri 10% dhe nëse pjesëmarrja e vlerës së tenderëve në të cilët ka vetëm një ofertë është nën 38%, aq sa është mesatarja nacionale në vend për vitin 2022.

Sa u përket këtyre treguesve, Ministria për Financa ka performansat më të dobëta duke e pasur parasysh që ka fituar vetëm nga 1 ofertë në procedurat, në bazë të cilave janë lidhur 55% e kontratave në vitin 2022. Përkatësisht, kjo ministri ka lidhur gjithsej 84 kontrata për prokurime publike dhe prej tyre 46 kontrata janë lidhur në procedura në të cilat ka marrë pjesë vetëm një ofertues. Vlera e këtyre kontratave është 1,4 milion euro dhe është me pjesëmarrje prej 54% në vlerën totale të prokurimeve në vitin 2022.



Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor më poshtë, me radhë është Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, ku pjesëmarrja e kontratave të lidhura në procedurat në të cilat është fituar vetëm një ofertë arrin deri 47%. Gjatë kësaj, nga gjithsej 30 kontrata të lidhura, nga një ofertë është fituar në procedura në bazë të cilave janë lidhur 14 kontrata. Këto kontrata arrijnë vlerën prej 3,8 milionë euro dhe kanë pjesëmarrje prej 97%. Në raport me këta dy tregues, edhe Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta, Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministria për Punë të Brendshme kanë performansa jashtëzakonisht të dobëta.

Vetëm Ministria për Vetëqeverisje Lokale nuk ka tenderë në të cilët ka pasur vetëm një ofertues. Megjithatë, këtu bëhet fjalë për autoritet kontraktues, i cili në këtë grup ka numrin më të vogël të procedurave të zbatuara (17) si dhe kontratave të lidhura (10) në vlerë prej më pak se 40 mijë euro.

**Tenderët me një ofertë në totalin e tenderëve të zbatuar**

Institucioni	Përqindja e tenderëve me vetëm një ofertë	Pjesa e vlerës së tenderëve me vetëm një ofertë
Ministria për Financa	55%	54%
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë	47%	97%
Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta	47%	42%
Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	41%	43%
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	40%	45%
Ministria për Punë të Brendshme	38%	48%
Ministria për Arsim dhe Shkencë	37%	22%
Ministria për Punë të Jashtme	36%	54%
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	31%	20%
Sekretariati për Çështje Evropiane	31%	13%
Ministria për Ekonomi	31%	11%
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	31%	7%
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujërat	29%	31%
Ministria për Drejtësi	29%	22%
Ministria për Shëndetësi	26%	32%
Ministria për Mbrojtje	22%	6%
Ministria për Transport dhe Lidhje	22%	2%
Ministria për Kulturë	19%	17%
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	0%	0%

**Në 8 ministri është vërejtur një pjesëmarrje e lartë e vetëm një kompanie në vlerën e përgjithshme të prokurimeve publike, e cila shkon mbi 30%.**

Në rangimin e institucioneve monitorohet edhe niveli i dominimit të vetëm një kompanie në totalin e kontratave të prokurimeve publike. Në të njëjtën kohë, në vlerësimin me pikë nuk përdoret shuma absolute, por pjesëmarrja që një kompani e ka në vlerën e përgjithshme të kontratave të lidhura. Përqendrimi i një kompanie me pjesëmarrje më të lartë se 30% është negativ. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor në vijim, pjesëmarrja më e madhe e një kompanie në vlerën e përgjithshme të kontratave për prokurime publike është në Qeverinë e RMV-së, në Sekretariatit e Përgjithshëm. Bëhet fjalë për 2 kontrata të lidhura me Shoqërinë për shërbime komunikimi A1 Maqedoni SHPKPV





Shkup për blerjen e licencave softuerike për platformë virtuale dhe për blerje të një sistemi për arkivimin dhe mbrojtjen e të dhënave. Në shuma absolute, dominimi më i madh është konstatuar te Ministria për Punë të Brendshme, ku bëhet fjalë për një kontratë me vlerë prej 21,1 milion euro. Është një marrëveshje kornizë për blerjen e energjisë elektrike e lidhur me një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga një person ESM SHITJE SHPKPV Shkup për periudhë prej 36 muajsh.

#### Pjesëmarrje e një firme në kontratat për prokurime publike

Institucioni	Vlera e kontratave të lidhura me një kompani (pjesëmarrja) në euro	Pjesëmarrje në vlerën totale të prokurimeve
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	6,168,557	78%
Ministria për Ekonomi	420,661	67%
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	4,068,749	51%
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë	1,785,701	45%
Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	191,870	35%
Ministria për Mbrojtje	7,148,114	35%
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujërat	1,668,970	34%
Ministria për Punë të Brendshme	21,105,691	31%
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	11,512	29%
Sekretariati për Çështje Evropiane	123,212	28%
Ministria për Arsim dhe Shkencë	4,654,146	28%
Ministria për Drejtësi	191,102	28%
Ministria për Punë të Jashtme	374,146	26%
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	172,683	25%
Ministria për Transport dhe Lidhje	1,010,425	23%
Ministria për Kulturë	57,561	19%
Ministria për Shëndetësi	3,582,071	18%
Ministria për Financa	345,366	13%
Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta	385,081	12%

**Vetëm dy ministri nuk kanë përqindje të lartë të procedurave të anuluar të tenderëve, edhe atë Ministria e ekonomisë dhe Ministria për kulturë. Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria për Mbrojtje kanë përqindjen më të lartë të procedurave të anuluar në numrin total të procedurave të zbatuara.**

Treguesi tjetër që është përdorur ka të bëjë me anulimet e procedurave. Si standard mbi bazën e të cilit janë dhënë vlerësimet është përdorur përqindja mesatare e tenderëve të anuluar në nivel të vendit, e i cili është 31% në vitin 2022. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor në vijim, vetëm dy ministri kanë fituar maksimumin prej 2 pikë, edhe Ministria e Ekonomisë dhe Ministria për Kulturë. Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Mbrojtje, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, Ministria për Financa, Ministria për Shëndetësi, Ministria për Vetëqeverisje Lokale kanë përqindjen më të madhe të procedurave të anuluar në totalin e procedurave të zbatuara. Institucionet tjera qeveritare të vlerësuara në ngjyrën e verdhë kanë përqindje të procedurave të anuluar prej 15.5% deri në 31% në totalin procedurave të zbatuara.



**Pjesa e procedurave të anuluar për prokurime publike në vitin 2022**

Institucioni	Totali i procedurave të zbatuara	Totali i procedurave të anuluar	Procedura tërësisht të anuluar	Procedurat pjesërisht të anuluar
Ministria për Punë të Brendshme	196	180	102	78
Ministria për Mbrojtje	280	174	93	81
Ministria për Financa	98	34	29	5
Ministria për Transport dhe Lidhje	95	18	16	2
Ministria për Arsim dhe Shkencë	75	18	12	6
Ministria për Drejtësi	53	16	15	1
Ministria për Punë të Jashtme	53	15	10	5
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	46	14	7	7
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	58	13	12	1
Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta	82	13	9	4
Ministria për Shëndetësi	31	13	2	11
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujërat	55	11	8	3
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë	24	10	7	3
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	17	7	6	1
Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	21	5	5	0
Sekretariati për Çështje Evropiane	20	5	5	0
Ministria për Ekonomi	24	3	3	0
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë	21	3	3	0
Ministria për Kulturë	14	2	1	1


**Shkallë të lartë të aplikimit të procedurës jotransparente për lidhjen e kontratave, të ashtuquajturat negociata pa shpallje paraprake të konkursit kanë Ministria për Arsim dhe Shkencë dhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë.**

Matja e performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike e përfshin edhe treguesin për përdorimin e procedurës jotransparente të negociatave pa shpallje paraprake të konkursit, me atë që jepet vlerësim negativ nëse institucioni ka pjesëmarrje prej më tepër se 10% në këtë lloj kontratash.

Siç mund të shihet edhe nga prezantimi grafik në vijim, Ministria për Arsim dhe Shkencë ka përqindjen më të lartë të kontratave të lidhura përmes procedurës jotransparente me kontrata të lidhura të cilat arrijnë vlerën prej 3,2 milionë euro dhe pjesëmarrje prej 19.62%. Edhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë ka pjesëmarrje të lartë në këtë lloj kontratash, me 10.68%, që është rezultat i kontratave të lidhura në vlerë 425 mijë euro.



Pjesëmarrja në vlerën e tenderëve të zbatuar pa shpallje, në negociata të drejtpërdrejta me kompanitë



**Në segmentin e mbrojtjes ligjore, një numër i ankesave më i lartë nga mesatarja janë në Qeverinë dhe pjesa më e madhe nga ministrinë.**

Sa i përket mbrojtjes ligjore në prokurimet publike, janë përdorur dy tregues të rëndësishëm, edhe atë në lidhje me numrin e ankesave të paraqitura nga Komisioni Shtetëror për Ankesa lidhur me Prokurimet Publike nga kompanitë pjesëmarrëse në tenderë dhe sa nga ankesat e paraqitura janë pranuar. Në procesin e matjes, janë përdorur të dhëna relative, përkatësisht përqindja e ankesave në raport me numrin total të tenderëve dhe përqindja e ankesave të miratuara nga numri total i ankesave. Vlerësohet pozitivisht nëse përqindja e ankesave në raport me numrin total të tenderëve është nën mesataren nacionale prej 3.27%, kurse në raport me ankesat e pranuar nëse përqindja e tyre është nën mesataren nacionale prej 40.30%.

Gjatë vitit 2022, në Ministrinë për Ekonomi, në Ministrinë për Kulturë dhe në Ministrinë për Vetëqeverisje Lokale nuk është paraqitur asnjë ankesë për tenderët e tyre.


Nga ana tjetër, përqindje më të lartë se mesatarja e ankesave në raport me procedurat e zbatuara kanë Qeveria, SÇE dhe 12 ministri. Përqindjet më të larta i kanë Ministria për Punë të Brendshme (20%), Ministria e Shëndetësisë (17%) dhe SÇE (15%).

Në shuma absolute, siç mund të shihet nga prezantimi grafik, numrin më të madh të ankesave kanë marrë Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria për Mbrojtje.

Vështruar nga aspekti i ankesave të pranuar, përqindjen më të lartë, edhe atë prej 22% e ka Ministria për Punë të Brendshme. Gjithsej 7 nga institucionet e monitoruara janë vlerësuar negativisht në bazë të këtij parametri.



Numri i ankesave të paraqitura dhe numri i ankesave të pranuar nga KSHAPP



**Kontratat e lidhura për prokurime publike shpesh i ndryshuar nga Ministria për Arsim dhe Shkencë. Sa u përket anekseve të marrëveshjeve, me të cilat zmadhohet vlera e kontratës bazë, ndryshimet më të mëdha janë vërejtur në Ministrinë për Transport dhe Lidhje.**


Në fazën e realizimit të kontratave të lidhura për prokurime publike, janë përfshirë tre tregues të rëndësishëm edhe atë:

- numri i ndryshimeve në kontratat e lidhura, përkatësisht aneks-kontratat në të gjitha bazat – vlera, afati ose kushtet tjera dhe pjesëmarrja e tyre në totalin e kontratave të lidhura;
- vlera totale e rritjeve të kontratave bazë nëpërmjet aneks kontratave dhe përqindja të cilën e ka vlera e zmadhuar në vlerën totale, si dhe
- nëse institucioni ka sistem të vendosur për monitorimin e realizimit të kontratave të lidhura.

Sa i përket treguesit për numrin e përgjithshëm të ndryshimeve të marrëveshjeve të lidhura (aneks-marrëveshjet) dhe pjesëmarrjen e tyre në totalin e marrëveshjeve të lidhura, është përdorur mesatarja nacionale prej 5.15%, me atë që institucionet të cilat kanë pasur një numër më të vogël ndryshimesh janë vlerësuar pozitivisht dhe e kundërta. Sa i përket këtij treguesi, matjet tregojnë se shtatë institucione më shpesh i kanë ndryshuar kontratat e nënshkruara në raport me mesataren nacionale të ndryshimeve. Gjatë kësaj, në vitin 2022, numrin më të madh të ndryshimeve i ka bërë Ministria për Arsim dhe Shkencë, duke bërë ndryshime në kontratat edhe atë deri 38 herë, përkatësisht 51.11% të kontratave të lidhura. Nëse futemi në analizë të arsyeve, rezultojnë se për 18 kontrata, arsyeja ka qenë që të ndryshohet kohëzgjatja, në 17 aneks kontrata, arsyeja ka qenë që të ndryshohet vlera dhe në 3 kontratat që ngelin arsyet janë tjera. Në vend të dytë sipas vlerës së këtij treguesi është Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, e cila në vitin 2022 ka bërë 10 ndryshime në kontratat e lidhura, që paraqet 18.52%. Më pas është Ministria për Transport dhe Lidhje me 9 ndryshime në kontratat e lidhura, që paraqet pjesëmarrje prej 12.16% dhe në vendin e katërt është Ministria për Mbrojtje, e cila ka lidhur 40 kontrata aneks, me të cilat ka pjesëmarrje prej 11.24% kontrata të ndryshuara në raport me totalin e kontratave të lidhura.



Ndryshime në marrëveshjet e lidhura (aneks kontratat)



Gjatë kësaj, Sekretariati për Çështje Evropiane, si dhe 4 ministri (Ministria për Ekonomi, Ministria për Kulturë, Ministria për Vetëqeverisje Lokale, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale) aspak nuk kanë lidhur aneks-kontrata.

Sa u përket aneks kontratave me të cilat rritet vlera e kontratës bazë, vlerësimi konsiderohet se është negativ nëse institucioni nëpërmjet aneks kontratave ka bërë ndryshime në vlerën e kontratave bazë për më të tepër se 3.60% nga vlera totale në prokurimeve publike, që paraqet mesataren në nivel shtetëror.


Siç mund të shihet nga prezantimi grafik në vijim, sipas këtij treguesi, në vitin 2022 negativisht është vlerësuar vetëm Ministria për Shëndetësi, e cila me aneksim i ka zmadhuar kontratat bazë për prokurime publike në vlerë prej 65 milionë denarë, përkatësisht mbi 1 milion euro, që përbën pjesëmarrje me 5.29% në vlerën e përgjithshme të prokurimeve.

Në radhë, sipas vlerës dhe pjesëmarrjes është Ministria për Arsim dhe Shkencë, e cila i ka aneksuar kontratat në vlerë prej 29 milionë denarë, përkatësisht 470 mijë euro. Pjesëmarrja e Ministrisë për Arsim është me 2.88% dhe është nën mesataren ligjore.

Të gjitha institucionet e tjera që janë paraqitur në prezantimin grafik më poshtë janë vlerësuar pozitivisht për shkakun që janë nën mesataren nacionale. Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet që Sekretariati për Çështje Evropiane, si dhe 5 ministri (Ministria për Ekonomi, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra, Ministria për Kulturë, Ministria për Vetëqeverisjen Lokale, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale) as nuk kanë lidhur aneks kontratë për ndryshim të vlerës së marrëveshjeve bazë.



### Pjesëmarrja në vlerën e kontratave të ndryshuara për të rritjen e vlerës së kontratës bazë



Në treguesit për vlerësimin e performansave për parandalim të korrupsionit është vlerësuar edhe nëse institucionet kanë të instaluar sistem për monitorimin e realizimit të kontratave të lidhura. Nga përgjigjet e institucioneve, është vlerësuar se nga 19 institucione qeveritare, tre ministri nuk kanë sistem të tillë, përkatësisht Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Ministria për Vetëqeverisje Lokale dhe Ministria për Arsim dhe Shkencë.

### Transparenca në prokurimet publike ende nuk është në nivelin e duhur. Dobësi janë vërejtur edhe në aspekt të publikimit të informacioneve me kohë në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike, si dhe në aspekt të publikimit të informacioneve në faqet e internetit të institucioneve.

Transparenca në lidhje me informacionet për prokurimet publike, si element veçanërisht i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit është matur përmes gjashtë treguesve, nga të cilët, njëra pjesë ishte në lidhje me respektimin e afateve ligjore për sa i përket publikimit të informacioneve në Sistemin Elektronik për Prokurimet Publike, kurse pjesa tjetër e treguesve ishte në lidhje me publikimin e informacioneve dhe dokumenteve në ueb-faqet e institucioneve. Është me rëndësi të theksohet që analiza e të dhënave të publikuara është bërë në periudhën tetor dhe nëntor të vitit 2023 dhe se ekziston mundësia që disa nga institucionet t'i kenë publikuar dokumentet që mungojnë, por kjo megjithatë nuk është bërë me kohë.

Në lidhje me publikimin e informacioneve në SEPP-në, si tregues janë përdorur respektimi konsekuent i detyrimit për publikimin e njoftimeve për kontrata të lidhura, evidencat tremujore dhe njoftimet për kontratave të realizuara.

Sa i përket publikimit të njoftimeve për kontratë të lidhur në afatin prej 10 ditësh nga dita e lidhjes së kontratës, pozitivisht janë vlerësuar ato institucione, të cilat këtë afat e kanë respektuar në më shumë se 90% të kontratave të lidhura. Është vërejtur se vetëm pesë institucione e kanë respektuar në mënyrë konsekuente këtë detyrim, përkatësisht Ministria për Ekonomi, Ministria për Shëndetësi, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra, Ministria për Transport dhe Lidhje dhe SHPPP.

Sa u përket evidencave tremujore, publikimi me kohë i të 4 evidencave është vërejtur vetëm në tre ministri, përkatësisht Ministrinë për Kulturë, Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra dhe Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale.

Në lidhje me njoftimet për kontratat e realizuara, për të cilat përlogaritjet janë bërë pas përfundimit të vitit 2023, rezulton se 12 institucione qeveritare e kanë respektuar detyrimin dhe në SEPP kanë dërguar njoftim për më tepër se 80% të kontratave, ndërsa 7 prej institucioneve nuk kanë dërguar njoftime në atë vëllim.



Sa u përket informacioneve dhe dokumenteve që duhet të publikohen në ueb-faqet e institucioneve, këtu bëjnë pjesë planet vjetore për prokurime publike si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre, pastaj shpalljet për prokurime publike dhe njoftimet për kontratat e lidhura, kontratat dhe anekset. Siç mund të shihet, 13 ministri në mënyrë konsekuente i përbushin këto detyrime. Mungesë transparence në lidhje me informacione relevante për prokurimet publike, të plotë apo të pjesshme, ka në Ministrinë për Drejtësi, Ministrinë për Kulturë, Ministrinë për Ekonomi, Ministrinë për Punë të Jashtme dhe Ministrinë për Arsim dhe Shkencë, si dhe në SHPPP të Qeverisë.

**Publikimi i informacioneve në faqet e internetit të institucioneve**

Institucioni	A i publikon planin vjetor për prokurime publike dhe ndryshimet e tij në faqen e internetit?	A i publikon institucioni shpalljet për prokurime publike në ueb-faqen e vet?	A i publikon institucioni njoftimet për kontratë të lidhur, kontratat dhe anekset në ueb-faqen e vet?
Ministria për Drejtësi	jo	jo	po
Ministria për Kulturë	jo	jo	jo
SHPPP	jo	jo	jo
Ministria për Ekonomi	po	jo	jo
Ministria për Punë të Jashtme	po	jo	jo
Ministria për Arsim dhe Shkencë	po	jo	jo
Ministria për Punë të Brendshme	po	po	po
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	po	po	po
Ministria për Shëndetësi	po	po	po
Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujërat	po	po	po
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë	po	po	po
Ministria për Vetëqeverisje Lokale	po	po	po
Ministria për Mbrojtje	po	po	po
Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	po	po	po
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	po	po	po
Ministria për Financa	po	po	po
Ministria për Transport dhe Lidhje	po	po	po
Sekretariati për Çështje Evropiane	po	po	po
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	po	po	po



## ANALIZA E PERFORMANSAVE PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMET PUBLIKE TË KOMUNAVE


Asnjë komunë nuk i zbaton prokurimet publike me shkallë të lartë të mbrojtjes nga korrupsioni. Shumica e komunave, pra 43 prej tyre, duke përfshirë këtu edhe Qytetin e Shkupit, kanë nivel të ulët të performansave për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike dhe mesatarisht përmbushin vetëm 49% nga 100% të mundshme. Komuna e Kratovës dhe Komuna e Gostivarit janë në vendet e fundit në aspekt të performansave me 31%, ndërsa në vendet më të lartë është komuna e Kavadarit me 70%.

Rangimi e komunave është bërë duke u bazuar në 32 tregues që mundësojnë një vlerësim objektiv dhe të matshëm të kapaciteteve institucionale dhe operative të institucioneve në të gjitha fazat e prokurimeve publike, përkatësisht në fazën para tenderit, të tenderit dhe pas tenderit.

Treguesit që janë përdorur për rangimin e komunave janë identikë me ato që janë përdorur për ministritë, që është e logjikshme nëse merret parasysh që sipas Ligjit për Prokurime Publike, të gjithë i kanë të njëjtat detyrime.

